

URDHËR
Nr. 94, datë 21.7.2021

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 395, datë 13.5.2020, “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësim”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, drejtorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse, znj. Klodiana Guci.
2. Kompetencat e titullarit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin do të ushtrohen për periudhën nga data 3.8.2021 deri në datën 9.8.2021.
3. Nuk delegohen kompetenca të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet drejtori i financës dhe shërbimeve mbështetëse, znj. Klodiana Guci.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Erlis Hereni